



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA RAJONALE E UJËSJELLËS KANALIZIME VJORË SH.A

Nr. _____, Prot.

Vlorë, më ____ . ____ .2026

Shtojca 12.

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT
FILLOJNË AFATET E ANKIMIMIT**

Data: 15.07.2026

Drejtuar: Operatorit ekonomik **INSTITUTI DEKLIADA - ALB**

(Adresa: Rruga Ukraina e Lire, pallati Tecnoprojekt, njesia bashkiake nr 5, bashkia Tirane)

& ARENA MK

(Adresa: Fier, Ballsh Fshati Ninësh; Rruga Dames -Ninesh; Ndertesa 4; Lagja Memaj, Nj.
Adm. Fratar; Bashkia Mallakaster 9328)

Tipi i Kontratës: **Sherbim**

Lloji i Procedurës së prokurimit: **Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar**

Numri i procedurës / referenca e Lotit: **Ref-89796-06-11-2026**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **Objekti:** “Studim Projektim Sistemi i mbledhjes së ujërave të ndotura në zonën e Drimadhes dhe Impianti i trajtimit të ujërave të ndotura” **Kohezgjatja e Kontrates:** 8 (tetë) muaj

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: **12.06.2026**

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletinin e Njoftimeve Publike: **Buletini Nr. 39 datë 15 Qershor 2026**

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomike më e favorshme bazuar në kosto ☒ X

oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmim ☐

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. INSTITUTI DEKLIADA - ALB
& ARENA MK
Emri i plotë i shoqërisë

K71606006A
L67619801Q
Numri i NIPT-t

Vlera: 17,400,000 (shtatembedhjetë milion e kater qind mije) **Lekë Pa TVSH**
(e shprehur në shifra dhe fjalë)

Totali i pikëve të marra **259,20 Pikë**

2. B.O.E MAGNA CHARTA
& HTS COMPANY
& HE & SK 11

L92318021H
M11619018P
L19008502B
Numri i NIPT-t

Emri i plotë i shoqërisë

Vlera: 17,334,583.4 (shtatembedhjetë milion e treqind e tridhjetë e kater mije e pesëqind e tetëdhjetë e tre pike kater) **Lekë Pa TVSH**
(e shprehur në shifra dhe fjalë)

Totali i pikëve të marra **247,20 Pikë**

3. B.O.E CIVIL CONS
& TRANSPORT HIGHWAY CONSULTING

L81315015O
K51428048I
Numri i NIPT-t

Emri i plotë i shoqërisë

Vlera: 17,529,354 (shtatembedhjetë milion e pesëqind e njezet e nente mije e treqind e pesëdhjetë e kater) **Lekë Pa TVSH**
(e shprehur në shifra dhe fjalë)

Totali i pikëve të marra **0 Pikë**

4. InfraKonsult

L21512022F
Numri i NIPT-t

Emri i plotë i shoqërisë

Vlera: 17,724,000 (shtatembedhjetë milion e shtatëqind e njezet e kater mije) **Lekë Pa TVSH**
(e shprehur në shifra dhe fjalë)

Totali i pikëve të marra **250.80 Pikë**

5. GR ALBANIA
& LEAD CONSULTING

L01509004N
L82322016N
Numri i NIPT-t

Emri i plotë i shoqërisë

Vlera: 18,503,207 (tetembedhjetë milion e pesëqind e tre mije e dyqind e shtatë) **Lekë Pa TVSH**
(e shprehur në shifra dhe fjalë)

Totali i pikëve të marra **0 Pikë**

6. DIAR Engineering

M31926018P
Numri i NIPT-t

Emri i plotë i shoqërisë

Vlera: Nuk ka dorëzuar ofertë ekonomike
(e shprehur në shifra dhe fjalë)

Totali i pikëve të marra **0 Pikë**

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. GR ALBANIA
& LEAD CONSULTING

L01509004N
L82322016N
Numri i NIPT-t

Emri i plotë i shoqërisë

Vlera: 18,503,207 (tetembedhjetë milion e pesëqind e tre mijë e dyqind e shtatë) **Lekë Pa TVSH**

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

Totali i pikëve të marra **0 Pikë**

Bashkimi i Operatoreve ekonomik GR ALBANIA shpk & LEAD CONSULTING shpk, nuk ploteson Kriteret e Vecanta për Kualifikim, pika :

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme në punët e realizuara, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Punë të ngjashme për realizimin e një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më pak se 40% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet.

Për të vërtetuar këtë Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë Kontratën e shërbimit; vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë Kontratë Shërbimi dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë edhe kontratën e bashkimit të operatorëve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet, që ka marrë përsiper të kryejë secili anëtar i BOE

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Nga dokumentacioni i dorëzuar në rruge elektronike rezulton se OE LEAD CONSULTING shpk ka paraqitur shërbime të mëparshme të ngjashme si më poshtë:

1. Kontratë me objekt: **“Studim projektim: Ndertim dhe shtim i kapacitetit të sistemit të furnizimit me ujë në blloqet nr.1, 2, 3 , në lagjen Mar Lula, Shkoder” me vlerë 15,537,895 leke pa TVSH**, kontratë e realizuar në formën e bashkimit të operatorëve, nga ku rezulton se OE nuk ka paraqitur kontratën e bashkimit të operatorëve shoqëruar me tabelën e ndarjes së shërbimeve, ku të cilësohen shërbimet, që ka marrë përsiper të

kryejë secili anëtar i BOE, sipas kriterit per kualifikim te kerkuar nga AK ne Dokumentat Standarte te Tenderti.

2. Kontratë me objekt: **“Studim projektim, oponente teknike per objektin Rikonstrukcion i blloqeve te banimit ne lagjen 1 Maj ” me vlerë 3,493,170 leke pa TVSH**, kontrate e realizur ne formen e bashkimit te operatoreve, nga ku rezulton se OE nuk ka paraqitur kontratën e bashkimit të operatorëve shoqëruar me tabelën e ndarjes së sherbimeve, ku të cilësohen sherbimet, që ka marrë përsiper të kryejë secili anëtar i BOE, sipas kriterit per kualifikim te kerkuar nga AK ne Dokumentat Standarte te Tenderti. Gjithashtu kjo kontrate nuk eshte e ngjashme me natyren e objektit qe prokurohet.

Nga dokumentacioni i dorezuar ne rruge elektronike rezulton se OE GR ALBANIA shpk ka paraqitur sherbime te meparshme te ngjashme si me poshte:

1. Kontratë me objekt: **Vleresim Paraprak i Ndikimit ne Mjedis, Vleresim Ekologji, Mbeshtetje Lejesh dhe projektim i detajuar per parkun Fotovoltaion ne rrethin e Fierit**, me vlerë **536,364.02 Euro lek pa tvsh**, në të cilën ky operator ekonomik ka realizuar 100% të kontratës, dhe Kontrate me objekt: **Vleresim Paraprak i Ndikimit ne Mjedis, Sherbime Multidisiplinare dhe Projektimi i detajuar per Parkun Fotovoltaik ne rrethin e Fierit**, me vlere **1,027,749 Euro pa TVSH**, kontarta keto qe per nga natyra e sherbimit nuk jane te ngjashme me ate te objektit te prokurimit.
2. Kontratë me objekt: **Rishikim projekti Mbikqyrja e Punimeve dhe kontrolli i cilesise per Skemat e ujitjes Divjake dhe Janjar-Musi**, me vlerë **29,890 Euro lek pa tvsh**, nga ku rezulton se ky oe nuk ka kryer sherbime te ngjashme me natyren e objektit te prokurimit.

Persa me siper, referuar dokumentacionit te paraqitur nga ky Bashkim Operatoresh, rezuton se ky BOE nuk e ploteson kriterin per kualifikim me dy prej komponenteve perberes te saj, ne natyre (sherbime te ngjashme me natyren e objektit te prokurimit), si dhe ne vlere (sipas kriterit per kualifikim, sa 40% e fondit limit te parashikuar nga AK). BOE ka paraqitur sherbime te ngjashme sa i takon komponentin kohe (brenda 3 viteve te fundit nga data e shpalles se njoftimit te kontrates), te cilat nuk jane as te ngjashme me natyren e sherbimit qe kerkohet te kryhet per proceduren objekt prokurimi, si dhe referuar dokumentacionit te paraqitur per keto kontrata nuk rezulton qe sherbime te cilat mund te konsiderohen pervoje e ngjashme nuk jane sherbime te kryer nga OE ofertues per kete procedure prokurimi.

Gjithashtu, sa i takon sherbimeve te realizuara ne formen e bashkimit te operatoreve, BOE, nuk ka paraqitur Kontraten e Bashkepunimit dhe tabelen e ndarjes se sherbimeve qe merr persiper secili anetar i bashkimit te operatoreve.

Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave për shkak të ekonomicitetit procedural ka vlerësuar të panevojshëm vijimin e verifikimit të dokumenatcionit të operatorit ekonomik, duke qënë se përsëri statusi juridik i këtij operatori do të mbetet i skualifikuar.

Bazuar në Nenin 92 paragrafi 3 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar me Ligjin Nr.16 datë 08.02.2024 ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pranë Autoritetit Kontraktor bëri s’kualifikimin e **Bashkimit të Operatoreve Ekonomik Shoqeria “GR ALBANIA” shpk & “LEAD CONSULTING” shpk.**

2. DIAR Engineering

M31926018P

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Vlera: Nuk ka dorëzuar ofertë ekonomike
(e shprehur në shifra dhe fjalë)

Totali i pikëve të marra **0 Pikë**

Operatori Ekonomik Shoqeria “DIAR ENGINEERING” shpk, nuk ploteson Kriteret e Përgjithshme për Kualifikim dhe Kriteret e Vecanta për Kualifikim, sipas Shtojces Nr.9 të Dokumentave Standarte të Tenderit, të publikuar nga AK për këtë procedurë prokurimi, pasi rezulton se nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion.

Komisioni vlerëson se Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.

Bazuar në Nenin 92 paragrafi 3 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar me Ligjin Nr.16 datë 08.02.2024 ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të

gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pranë Autoritetit Kontraktor bëri s’kualifikimin e **Operatorit Ekonomik Shoqëria “DIAR ENGINEERING” shpk**

**3. B.O.E CIVIL CONS
& TRANSPORT HIGHWAY CONSULTING**

L813150150
K51428048I

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Vlera: 17,529,354 (shtatembedhjete milion e peseqind e njezet e nente mije e treqind e pesedhjete e kater) **Lekë Pa TVSH**
(e shprehur në shifra dhe fjalë)

Totali i pikëve të marra **0 Pikë**

Bashkimi i Operatoreve Ekonomike Shoqëria “CIVIL CONS” & Shoqëria “T H C” shpk, nuk ploteson Kriteret e Vecanta per Kualifikim, Pika

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10.*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Nga dokumentacioni i dorezuar elektronikisht rezulton se BOE nuk ka paraqitur Sigurimin e Ofertes, sipas Shtojcës 3 te kerkuar nga AK ne Dokumentat Standarte te Tenderit.

Referuar nenit 83, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: *1. Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël. Në rastin e kontratave sektoriale, enti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, ndërkohë që mund të kërkojë paraqitjen e këtij sigurimi edhe në procedurat nën kufirin e lartë monetar, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.*

2. Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit: a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlllogaritur të kontratës; b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor pranon mundësinë e pagesës nga ofertuesi, në vlerë monetare në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor. Përveç kësaj forme të paraqitjes së sigurimit të ofertës, autoriteti ose enti kontraktor, sipas vlerësimit të tij, duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit mundësinë e paraqitjes së sigurimit të ofertës: i. në formën e garancisë bankare; ose ii. nga shoqëri sigurimi të licencuara nga autoritetet kompetente.

3. Autoriteti ose enti kontraktor konfiskon sigurimin e ofertës në rast të: a) tërheqjes së ofertës pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave; b) refuzimit për nënshkrimin e kontratës së prokurimit. c) mosparaqitjes së sigurimit të kontratës, kur oferta është shpallur fituese, ose mosplotësimit të ndonjë kushti tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentet e tenderit.

4. Autoriteti ose enti kontraktor nuk e pretendon vlerën e sigurimit të ofertës dhe kthen menjëherë mbrapsht dokumentin e sigurimit e ofertës, nëse: a) ka përfunduar afati kohor i sigurimit të ofertës; b) është lidhur kontrata dhe është paraqitur sigurimi i kontratës, kur një

gjë e tillë kërkohet nga dokumentet e tenderit; c) janë anuluar procedurat e tenderit pa shpallur fitues.

5. Autoriteti ose enti kontraktor raporton pranë Agjencisë së Prokurimit Publik rastet e tërheqjes së operatorit ekonomik sipas parashikimeve të këtij neni.

6. Kur ofertuesi fitues nuk bën sigurimin e kontratës ose nuk nënshkruan kontratën, autoriteti kontraktor bën konfiskimin e sigurimit të ofertës. Në rastin kur është përdorur si kriter i përcaktimit të ofertës fituese “oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim” dhe kur ofertuesi fitues nuk bën sigurimin e kontratës ose nuk arrin të nënshkruajë kontratën, autoriteti kontraktor përzgjedh ofertuesin e renditur i dyti në listën e ofertave të përzgjedhura që kanë mbetur; vetëm nëse diferenca ndërmjet ofertës së kualifikuar në vendin e parë dhe të dytë është jo më e madhe se vlera e sigurimit të ofertës të ofertuesit që është tërhequr.

Komisioni vlerëson se Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.

Përsa më sipër nga verifikimi rezultron se ky operator ekonomik nuk ka paraqitur Shtojcën Nr.3, duke mos plotësuar kështu dokumentacionin e kërkuar nga ky operator sipas kërkesave të autoritetit kontraktor në dokumentat standarte të tenderit. Ndodhur në kto kushte operatori ekonomik është në mospoltësim të kriterëve të vendosura nga autoriteti kontraktor.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave për shkak të ekonomicitetit procedural ka vlerësuar të panevojshëm vijimin e verifikimit të dokumentacionit të operatorit ekonomik, duke qënë se përsëri statusi juridik i këtij operatori do të mbetet i skualifikuar.

Bazuar në Nenin 92 paragrafi 3 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar me Ligjin Nr.16 datë 08.02.2024 ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pranë Autoritetit Kontraktor bëri s'kualifikimin e **Bashkimit të Operatoreve Ekonomik Shqeria “CIVIL CONS” & Shqeria “T H C” shpk.**

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **B.O.E INSTITUTI DEKLIADA - ALB** me NIPT **K71606006A** me adrese: **Rruga Ukraina e Lire, pallati Tecnoprojekt, njesia bashkiake nr 5, bashkia Tirane & ARENA MK** me NIPT **L67619801Q** me adrese: **Fier, Ballsh Fshati Ninësh; Rruga Dames -Ninesh; Ndertesa 4; Lagja Memaj; Nj.Adm.Fratar; Bashkia Mallakaster 9328**, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej : **17,400,000** (*shtatembedhjetë milion e katerqind mije*) **Lekë Pa TVSH** / totali i pikëve të marra **259,20** është identifikuar si fitues (paraprak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR